



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 72, Datë 08.04.2025

MBI

**ZGJATJEN E VENDIMMARRJES SË BORDIT TË ERE-S LIDHUR ME SHQYRTIMIN
E KËRKESËS SË SHOQËRISË “5GX ENERGY” SH.P.K. PËR MARRJEN E
AUTORIZIMIT NGA ERE PËR TRANSFERIMIN (NËPËRMJET VENDOSJES SË
BARRËS SIGURUESE) TË ASETEVE FIKSE TË SAJ**

Në mbështetje të neneve 16, 20, gërma “a”, dhe 44, pika 1, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 67 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 15, të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 08.04.2025, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 35/13 prot., datë 01.04.2025, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve, “Mbi kërkesën e shoqërisë “5GX ENERGY” sh.a. për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin (nëpërmjet vendosjes së barrës siguruese) të aseteve fikse të saj”,

Konstatohet se:

- Për qëllime të shqyrtimit të këtij Aplikimi janë ndjekur procedurat dhe është analizuar dokumentacioni si vijon:

1. Paraqitja e Kërkesës për Licencim

- Shoqëria “5GX ENERGY” sh.a. me datë 08.01.2025, dorëzoi kërkesën për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin (nëpërmjet vendosjes së barrës siguruese) e aseteve fikse të saj, si mjet për garantimin e shlyerjes së detyrimit ndaj “TIRANA BANK” sh.a.

2. Fillimi i Procedurës për transferimin e aseteve

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 26, datë 27.01.2025, vendosi të fillojë procedurën për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë.
- ERE ka njoftuar shoqërinë dhe MIE-n në lidhje me këtë vendim nëpërmjet shkresës nr. 35/5 prot., datë 06.02.2025.

3. Vlerësimi i dokumentacionit dhe Kërkesa për Seancë Dëgjimore

- Me shkresat nr. 35/3 prot., dhe nr. 35/4 prot., datë 03.02.2025, ERE njoftoi shoqërinë dhe TIRANA BANK sh.a. për zhvillimin e seancës dëgjimore më datë 13.02.2025, duke i kërkuar shoqërisë plotësimin e dokumentacionit të munguar, përfshirë: gjendjen financiare në momentin e paraqitjes së kërkesës, marrëveshjen paraprake me listën e aseteve, çdo transferim të mëparshëm, si dhe qëndrimin lidhur me faktin që marrëveshja është nënshkruar pa marrë më parë autorizimin e ERE-s.
- Në vijim të seancës dëgjimore, me shkresën nr. 35/6 prot., datë 18.02.2025, ERE kërkoi depozitimin e angazhimeve të deklaruara gjatë saj. Gjatë seancës, përfaqësuesit e bankës dhe të shoqërisë deklaruan se do të anulonin marrëveshjen ekzistuese të barrës siguruese mbi asetet e shoqërisë, do të kryenin fshirjen e saj nga Regjistri i Barrës Siguruese dhe do të paraqisnin pranë ERE-s një marrëveshje të re, e cila do t'i nënshtrohej më parë miratimit të institucionit.

4. Dorëzimi dhe Vlerësimi i Dokumentacionit Plotësues

- Pas seancës dëgjimore të datës 13.02.2025, në mungesë të dokumentacionit përkatës, ERE, me shkresën nr. 35/6 prot., datë 18.02.2025, u kërkoi shoqërisë dhe bankës depozitimin e angazhimeve të deklaruara. Më pas, me shkresën nr. 35/7 prot., datë 19.02.2025, shoqëria kërkoi pezullimin e shqyrtimit deri në plotësimin e dokumentacionit të nevojshëm.
- Me e-mailin e datës 24.02.2025, ERE kërkoi dorëzimin e dokumentacionit të munguar që varej vetëm nga shoqëria, si dhe një afat të arsyeshëm për përmbushjen e tij. Si përgjigje, me shkresën nr. 35/8 prot., datë 27.02.2025, shoqëria plotësoi pjesërisht dokumentacionin dhe kërkoi pezullimin e procedurës deri më 17.03.2025.
- Në datën 17.03.2025, TIRANA BANK sh.a., me shkresën nr. 35/9 prot., shoqëria dorëzoi marrëveshjen e re siguruese nr. 534 rep., nr. 384 kol., datë 12.03.2025 dhe vërtetimin e fshirjes nga RBS të marrëveshjes së mëparshme nr. 2691 rep., nr. 1731 kol., datë 10.12.2024. Në të njëjtën datë, edhe shoqëria, me shkresën nr. 35/10 prot., përcolli të njëjtin dokumentacion.
- Me shkresën nr. 35/11 prot., datë 18.03.2025, ERE kërkoi sqarim nëse data 17.03.2025 përfaqësonte dorëzimin final të dokumentacionit apo datën e pritshme të formalizimit. Në vijim, me shkresën nr. 35/12 prot., datë 20.03.2025, shoqëria depozitoi marrëveshjen e re siguruese nr. 533 rep., nr. 383 kol., datë 12.03.2025, për vendosjen e barrës së radhës së parë në favor të TIRANA BANK sha, e bashkëlidhur këtij relacioni.

5. Shtyrja e Afatit të Vendimmarrjes

- Referuar nenit 67 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, bordi i ERE-s vlerëson zgjatjen me 30 ditë të vendimmarrjes në lidhje me kërkesën e shoqërisë “5GX ENERGY” sh.a. për transferimin e aseteve fikse të saj nëpërmjet vendosjes së barrës siguruese.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të zgjasë me 30 (tridhjetë) ditë afatin e vendimmarrjes së bordit të ERE mbi kërkesën e shoqërisë “5GX ENERGY” sh.a. për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin (nëpërmjet vendosjes së barrës siguruese) të aseteve fikse të saj si mjet për garantimin e shlyerjes së detyrimit ndaj “TIRANA BANK” sh.a.
2. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve, të njoftojë shoqërinë “5GX ENERGY” sh.p.k. vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI